



Misioni në Kosovë

Misionit të OSBE-së në Kosovë i është besuar roli udhëheqës për çështjet që kanë të bëjnë me ndërtim institucional dhe të demokracisë, me shtet ligjor dhe me të drejta të njeriut në rajon. Misioni e formon kështu një komponentë të veçantë apo "degë" të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe ndër të tjera është përgjegjëse edhe për trajnimin e administratorëve të policisë, civil dhe ata të drejtësisë; vazhdimin e zhvillimit të shoqërisë civile; përkrahjen e zhvillimit të mediave; organizimin dhe mbikqyrjen e zgjedhjeve; dhe mbikqyrjen, mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut.

ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

Misioni në Kosovë

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

Misioni i OSBE-së në Kosovë pjesë e detyrës së të cilit është ndërtimi institucional përmes departamentit të tij për të Drejta të Njeriut dhe Shtetit Ligjor po punon në riformimin e sistemit juridik të bazuar në parime demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Si mjet parimor për përmirësimin e gjyqësisë Sektori i Shtetit Ligjor së bashku me komunitetin juridik në Kosovë krijoi Institutin Juridik të Kosovës (IJK). Ky institut zyrtarisht i filloi aktivitetet e tij në gusht të vitit 1999 në cilësi të Sektorit të Trajnimit Juridik dhe në shkurt të vitit 2000 filloi të funksionoj si IJK

Objektivat

Detyrë e IJK është të trajnoj gjykatës dhe prokurorë të Kosovës. Aktualisht është ende pjesë e Sektorit të OSBE-së së Shtetit Ligjor. Sidoqoftë, plani është që t'i dorëzohet shtyllës së parë të UNMIK-ut (Policisë & Drejtësisë), në mënyrë që të absorbohet në të e më vonë të formohet Ministria e Drejtësisë. Përfundimisht të funksionoj si një institucion i qëndrueshëm që do të ofroj një trajnim të vazhdueshëm juridik mbi gjyqësinë dhe njohuritë fillestare juridike për anëtarët e tij të ardhshëm.



Arsimimi i vazhdueshëm juridik për gjyqësinë

Programi i Vazhdueshëm i Arsimimit Juridik (PVAJ) i IJK-së përfshinë aktivitetet e arsimimit si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj.

Instituti filloi aktivitetet e rregullta të trajnimit në Kosovë duke organizuar simpoziume mbi standardet për të drejta të njeriut dhe ligjit penal për të gjithë anëtarët e Gjyqësisë, nga shtatori gjatë dhe dhjetorit të vitit 1999, gjatë Sistemit Juridik Emergjent. Më pas, vlerësimet mbi nevojat dhe prioritetet e trajnimit për gjyqësinë e Kosovës i mundësuan IJK-së të përqëndroj trajnimin e tij në çështjet specifike juridike të interesit të madh. Vlerësimet e tilla të vazhduara përmbushen në bashkëpunim me Zyrtarët e departamentit të Shtetit Ligjor të OSBE-së.

Pas emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve të rinj në dhjetor të vitit 1999, qershor 2000 dhe gusht 2000, IJK ka ofruar seminare hyrëse mbi ligjin penal, procedurën e ligjit penal dhe atij civil në përpuethshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të cilat patën për qëllim të pajisin dhe plotësojnë njohuritë juridike. IJK ka organizuar seminare mbi akte akuzuese, akuzimin, gjykimin, apelimin dhe parimin e së vërtetës në procedurën penale si dhe seminarin e trajnimit mbi Masat Etike dhe Ndëshkimore.

PVAJ është poashtu e përbërë nga seancat specifike të trajnimit dhe përfshinë kategoritë siç janë seancat informative, seminarët, simpoziumet si dhe diskutimet në seminare dhe tryeza të rrumbullakta.



Për informata të tjera, kontaktoni me

Zyrën për informim publik të OSBE-së, Prishtinë

Zyra e shtypit: +381 38 500 162 ext. 260

Zyra e informimit publik: +381 38 500 162 ext. 145

Fax: +381 38 500 188 E-mail: press@omik.org

Website: www.osce.org/kosovo

Në vitin 2001, IJK organizoi seminare, seanca informative mbi çështjet siç janë: të drejtat e pronësisë, procedurat penale, sanksionet alternative dhe masat e arrestimit, çështjet e mjekësisë ligjore, trafikimin, bashkëpunimin në mes të policisë dhe gjyqësisë, posedimin e armëve, ligjin ndërkombëtar mbi dorëzimin e kriminelit shtetit dhe një diskutim i hapur mbi draftin penal dhe kodet procedurale.

Në vitin 2002, aktualisht, seminarët dhe seancat informative janë organizuar mbi çështjet që përfshijnë mbrojtjen e personave me sëmundje mentale dhe rininë në veprimet penale, sanksionet dhe masat alternative, strategjitë anti-korruptuese, draft ligjin mbi të miturit, trafikimin e personave dhe debatimin rreth pronave.

Pjesa tjetër e PVAJ është programi jashtë vendit për arsimim që përbëhet prej vizitave të studimit dhe praktikanët.

Vizitat kanë për qëllim të edukojnë dhe të avancojnë diskutimet rreth problemeve të sistemeve gjyqësore në vendet pas-komuniste dhe të ndajnë këtë përvojë me kolegët si mjet për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjes për të përmirësuar ushtrimet dhe teknikat aktuale të gjyqësisë në Kosovë.

Zakonisht, pjesëmarrësit vizitojnë Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionin kryesor juridik të vendit, ata udhëtojnë dhe vëzhgojnë procedurat e gjykatave të instancës së parë dhe të dytë. Në vitin 2001 u organizuan vizita në Poloni, Zvicërr, Holandë dhe Hagë. Për vitin 2002, IJK planifikon të organizoj vizita të studimit në Francë, Slloveni, Zvicërr dhe Hagë.

Në sistemin e huaj juridik praktikanëve i'u lejohe të vëzhgojnë dhe ndihmojnë gjykatësve apo prokurorëve në punë. Ky aktivitet ka për qëllim që të zhvilloj lëmi të caktuara të punës në magjistrim, siç janë përdorimi i logjikës juridike, teknikat e të pyeturit, lista e çështjeve gjyqësore dhe menaxhimi i gjykatës. Në përgatitje për praktikanë, pjesëmarrësit ndjekin një kurs intenziv tre-ditorë mbi institucionet gjyqësore të vendit që ata do të vizitojnë. Kur të kthehen do të organizohen seminare ku ata kanë mundësi të ndajnë përvojën me shokët e tyre.

Shkolla e ardhshme e magjistraturës

Në pajtueshmëri me diskutimet e vazhduara mbi selektimin dhe trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve të ardhshëm IJK së bashku me Departamentin e Drejtësisë krijojnë Programin Fillestar të Arsimimit Juridik (PFAJ) për gjykatësit dhe prokurorët e ardhshëm. Ky është një hap i rëndësishëm drejt qëllimit të IJK-së të shëndrrohet në shkollë të magjistraturës së Kosovës.

Partneriteti

IJK po punon ngusht me organizatat përpjekjet e të cilave janë të lidhura me trajnimin gjyqësor. Duhet të theksohet bashkëpunimi i ngushtë në mes të IJK-së

Agjencisë Evropiane për Rindërtim, Këshillit të Evropës dhe Departamentit të Shteteve të Bashkuara për Drejtësi. Ekspertët e ofruar nga KE ndihmojnë që instituti të organizoj aktivitetet të ndryshme trajnimi.

Për më tepër, për të plotësuar nevojat specifike të trajnimit gjyqësor, IJK bashkëpunon në baza të këtij rasti me institucione vendore dhe ndërkombëtare siç janë Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës, Shoqata e Avokatëve Amerikanë, Iniciativa Ligjore e Evropës Qendrore dhe Lindore, Banka Botërore dhe të tjerat.

Program trajnimi për shkathtësi praktike

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) po planifikon një Program trajnimi për shkathtësi praktike për të çuar përpara trajnimin e gjykatësve nga IJK. Kohë zgjatja e pritur e këtij programi është prej gjashtë muajsh deri në një vit. Programi i organizuar dhe i mbajtur përbrenda IJK-së do të ndihmojë këta gjykatës dhe prokurorë aktual të zotrojnë shkathtësitë praktike që kanë të bëjnë me procedurat e gjykatave dhe gjykimeve. Kjo përfshinë menaxhimin e arrestimit para gjykimit, të shkruarit e gjykimit dhe dënimit, menaxhimin e dhomës së gjykatës dhe marrjen e dëshmitarëve në gjykim.

Stafi

Deri më tani IJK ka një staf prej gjashtë ndërko-mbëtarësh dhe dhjetë vendorësh. Instituti udhëhiqet nga dy bashkë-drejtorë, një vendor dhe një ndërkombëtar

Objektet

Që nga marsi i vitit 2001, IJK ka objektet e veta në Prishtinë, në rrugën Ramiz Sadiku. Ndërtesa e renovuar pak kohë më parë përfshinë disa klasa dhe hapsira për konferenca si dhe bibliotekë me qasje në internet. Një klasë është e pajisur me pajisje për përkthim simultan, duke i mundësuar institutit të ofroj përkthime simultane në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Maj 2002

